



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

11 tetor 2021

Raporti i rregullt i punës

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Korrik – Shtator 2021

Bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës nr. 03/L-223, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan paraqet raportin e rregullt të punës.

Raporti i rregullt i punës së Gjykatës Themelore në Gjilan përfshinë periudhën raportuese nga 1 korrik deri më 30 shtator 2021.

I. Hyrje

Raporti i Gjykatës Themelore të Gjilanit paraqet të gjitha të dhënat statistikore për këtë periudhë, të arriturat, sfidat, por edhe pengesat që kanë qenë gjatë kësaj periudhe.

Ky raport është i bazuar në detyrat dhe objektivat e projektuara dhe të përcaktuara paraprakisht me Planin Vjetor të Punës, Planet Periodike dhe Planin Strategjik Operativ të Gjykatës.

II. Struktura e Gjykatës Themelore në Gjilan me Degët e saja

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit së bashku me Degët, Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, janë gjithsejtë 35 gjyqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës), të caktuar në departamente dhe divizione.

Gjykata Themelore në Gjilan – Selia, aktualisht ka 23 gjyqtarë (përfshirë edhe kryetarin e gjykatës).

Në Departamentin e Krimeve të Rënda aktualisht janë 6 gjyqtarë (duke përfshirë edhe Kryetarin e Gjykatës, Ramiz Azizi), në Departamentin për të Mitur punon një gjyqtar, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal punojnë 6 gjyqtarë, në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil punojnë 9 gjyqtarë dhe në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtjes punojnë 1 gjyqtar.

Dega e Gjykatës Themelore në Kamenicë: Kjo degë aktualisht 4 gjyqtarë, prej tyre 2 gjyqtar në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal të cilët i kryejnë edhe lëndët kundërvajtëse dhe 2 gjyqtarë në Divizionin Civil.

Dega e Gjykatës Themelore në Viti: Në këtë degë kemi aktualisht kemi 7 gjyqtarë, prej tyre 3 gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal, 3 gjyqtarë në Divizionin Civil. Gjyqtari mbikëqyrës i kësaj dege kryen procedurën paraprake dhe është i ngarkuar me 50 % të lëndëve civile, së bashku me gjyqtarët civilista. Ndërsa lëndët kundërvajtëse i kryejnë gjyqtarët penalista.

Dega e Gjykatës Themelore në Novobërdë: Në këtë degë kemi deleguar përkohësisht dy gjyqtarët nga Gjykata Themelore e Gjilanit, për lëminë penale dhe civile, por së fundi është kthyer edhe gjyqtari Boban Aleksiq, i cili do të gjykoj lëndët në lëminë civile dhe kundërvajtëse.

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit, lëndët ndahen me Sistemin e Programit SMIL, ashtu siç është caktuar me Rregulloren mbi veprimtarinë e gjykatave, ndërkohë lëndët urgjente ndahen në bazë të rotacionit.

III. Raportet statistikore

Të dhënat statistikore tregojnë që Gjykata Themelore e Gjilanit së bashku me degët, tregojnë që ka një rënie të zgjidhjes së lëndëve, për shkak të ndërprerjes së punës, për shkak Covid – 19, po ashtu edhe për shkak të shfrytëzimit të pushimeve vjetore nga gjyqtarët dhe stafi administrativ.

Gjykata Themelore Gjilan	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	<u>II - IV</u>
Dep. Krimeve të Rënda	Paraprake	280	<u>30</u>	310	<u>26</u>	284	<u>87 %</u>
	Penale	361	<u>51</u>	412	<u>52</u>	360	<u>102 %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	380	<u>67</u>	447	<u>51</u>	396	<u>76 %</u>
	Penale	1907	<u>283</u>	2190	<u>306</u>	1884	<u>108 %</u>
	Ekzekutimet penale – gjobë	270	<u>65</u>	335	<u>122</u>	213	<u>187 %</u>
	Ekzekutimet penale – burg	33	<u>8</u>	41	<u>22</u>	19	<u>275 %</u>
	Civile	4290	<u>598</u>	4888	<u>379</u>	4509	<u>63 %</u>
	Jashtëkontestimore	109	<u>19</u>	128	<u>10</u>	118	<u>53 %</u>
	Përmbartimore dhe ekzekutime civile	237	<u>102</u>	339	<u>90</u>	249	<u>88 %</u>
Dep. për të Mitur	Përgatitore për të mitur	20	<u>5</u>	25	<u>5</u>	20	<u>100 %</u>
	Penale para kolegjit	93	<u>23</u>	116	<u>17</u>	99	<u>74 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1387	<u>398</u>	1785	<u>384</u>	1401	<u>96 %</u>
	TOTALI	9367	<u>1649</u>	11016	<u>1464</u>	9552	<u>88 %</u>

Dega e Themelores Kamenicë	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II – IV %</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	47	<u>20</u>	67	<u>17</u>	50	<u>85 %</u>
	Penale	398	<u>64</u>	462	<u>63</u>	399	<u>98 %</u>
	Ekzekutime Penale – gjobë	74	<u>28</u>	102	<u>20</u>	82	<u>71 %</u>
	Ekzekutime Penale – burg	3	<u>2</u>	5	<u>1</u>	4	<u>50 %</u>
	Civile	1080	<u>149</u>	1229	<u>69</u>	1160	<u>46 %</u>
	Jashtëkontestimore	40	<u>8</u>	48	<u>3</u>	45	<u>38 %</u>
	Përmbarimi dokumentit autentik	27	<u>20</u>	47	<u>8</u>	39	<u>40 %</u>
	Kundërvajtje	386	<u>111</u>	497	<u>119</u>	378	<u>107 %</u>
	TOTALI		2055	<u>402</u>	2457	<u>300</u>	2157

Dega e Themelores Viti	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> <u>II – IV %</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	
	Paraprake	18	<u>12</u>	30	<u>8</u>	22	<u>67 %</u>
	Penale	1382	<u>128</u>	1510	<u>135</u>	1376	<u>105 %</u>
	Ekzekutimet penale - gjobë	55	<u>37</u>	92	<u>32</u>	60	<u>86 %</u>
	Ekzekutimet penale - burg	7	<u>1</u>	8	<u>2</u>	6	<u>200 %</u>
	Civile	2571	<u>387</u>	2958	<u>209</u>	2749	<u>54 %</u>
	Jashtëkontestimore	47	<u>16</u>	63	<u>9</u>	54	<u>56 %</u>
	Përmbarimi dokumentit autentik	183	<u>165</u>	348	<u>37</u>	311	<u>22 %</u>
	Kundërvajtje	385	<u>206</u>	591	<u>73</u>	518	<u>35 %</u>
TOTALI		4648	<u>952</u>	5600	<u>505</u>	5095	<u>53 %</u>

Dega e Themelores Novobërdë	Lëmia	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zqjdhura</u> <u>II – IV %</u>
		I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	11	<u>0</u>	11	<u>0</u>	11	<u>0 %</u>
	Penale	234	<u>18</u>	252	<u>15</u>	237	<u>83 %</u>
	Ekzekutimet penale – gjobë	12	<u>5</u>	17	<u>3</u>	14	<u>60 %</u>
	Ekzekutimet penale – burg	2	<u>0</u>	2	<u>0</u>	2	<u>0 %</u>
	Civile	283	<u>22</u>	305	<u>8</u>	297	<u>36 %</u>
	Jashtëkontestimore	220	<u>8</u>	228	<u>2</u>	226	<u>25 %</u>
	Përmbarimi dokumentit autentik	19	<u>10</u>	29	<u>9</u>	20	<u>90 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	126	<u>55</u>	181	<u>0</u>	181	<u>0 %</u>
TOTALI		907	<u>118</u>	1025	<u>37</u>	988	<u>31 %</u>

Statistikat e përgjithshme

Gjykata Themelore Gjilan së bashku me Degët

	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura %</u>
Totali	16977	3121	20098	2306	17792	73 %

IV. Përmbushja e objektivave

a) *Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre:* në Gjykatën Themelore të Gjilanit ishte tentuar që të bëhet në atë formë që gjyqtarët e Departamentit të Krimeve të Rënda të kenë prej 50-60 lëndë, ndërsa gjyqtarët e departamenteve të përgjithshme të dhomës penale dhe civile të kenë prej 300-400 lëndë, ndërsa ata të kundërvajtjes të kenë afër 500 lëndëve në punë me ngarkesë me lëndë gjatë vitit. Situata me e pavolitshme është në Degën e Vitisë dhe të Novobërdës, sidomos në degën civile për shkak të mungesës së gjyqtarëve.

b) Procedimi i lëndëve në kohë të arsyeshme: do të thotë se të gjitha lëndëve i'u është dhënë prioritet për një efikasitet më të lartë si dhe ato janë proceduar në një kohë të arsyeshme, me theks të veçantë, dhe lëndët e natyrave urgjente janë proceduar sipas dispozitave ligjore në fuqi, ndërsa një prioritet më i madh iu është dhënë lëndëve të natyrës së korrupsionit, me ç'rast është zvogëluar dukshëm numri i këtyre lëndëve.

c) Rritja e transparencës së gjykatës: ishte si objektivë e gjykatës sonë që gjatë kësaj periudhe të kontribuojmë edhe më tepër në rritje të transparencës me qytetarët, institucionet dhe me shoqërinë civile.

V. Sfidat e paraqitura

Disa nga sfidat të cilat janë paraqitur gjatë muajve korrik – shtator 2021 janë:

- a)** Pas përhapjes së pandemisë Covid-19, siç e dini gjatë vitit 2020, kemi pas ndërprerje të punës, ndërsa gjatë këtij viti nuk e kemi ndërprerë punë dhe kemi punuar me kapacitete të plota. Vlen të theksohet që gjyqtarët dhe zyrtarët të cilët kanë pasur simptoma apo kanë qenë me sëmundje kronike i kemi liruar për në shtëpi, e që numri i tyre është i konsiderueshëm. Një sfidë tjetër është mungesa e përkthyesve gjuhësor, që kjo për në si Gjykatë po paraqet mjaft problem. Ky problem si në qendër edhe në degë është i përhershëm, pasi që kem mungesë të 3 deri 4 përkthyes gjyqësor të gjuhës shqipe – serbe.
- b)** Për Gjykatën Themelore në Gjilan së bashku me degët nevojë urgjente mbetet plotësimi i vendeve të punës me staf administrativ, është e nevojshme shtimi i numrit të bashkëpunëtorëve profesional, ku së paku një gjyqtar duhet të ketë një bashkëpunëtor profesional. Po ashtu duhet të shtohet edhe numri i gjyqtarëve e posaçërisht nëpër degët Viti dhe Kamenicë.

c) Mos zbatimi i urdhëresave nga Policia e Kosovës dhe realizimi i tyre, si të lëndëve në procedurë penale si dhe lëndët e ekzekutimeve. Tani në fund të muajit shator ka filluar një numër i madh i zbatimit të ekzekutimit të urdhëresave nga ana e Stacionit Policor Gjilan.

d) Disa nga gjyqtarët - personeli administrativ të cilët janë në moshë te shtyrë dhe nuk mund të shfrytëzojnë teknologjinë që disponon gjykata me programet elektronike të menaxhimit të lëndëve.

f) Sfidë kemi pasur zbatimin e Programit SMIL, mirëpo tash kemi të regjistruar të gjitha lëndët në këtë sistem dhe jemi duke punuar me këtë sistem. Vlen të ceket se numri i lëndëve të përgjithshme në SMIL është shumë i madh në krahasim me lëndët që gjyqtarët janë të ngarkuar, andaj kërkojmë nga ju që kjo çështje të rregullohet, pasi që ne qëndrojmë më mirë me statistikat, nga ato që i paraqet Programi SMIL.

i) Mungesa e teknologjisë - audio dhe video ingjizimet, dhe përkthimeve simulantë kur dihet se gjykata disponon me 10 salla të gjykimit, ndërsa vetëm njëra prej tyre disponon këtë teknologji ndërsa sallat e gjykimeve nëpër degë nuk disponojnë këtë teknologji.

VI. Të arriturat

a) Kryetari ka shprehur gatishmërinë të luftojë krimin e korrupsionin, duke i bërë apel të gjithëve që ata që kanë informata të lajmërojnë rastin menjëherë.

b) Vazhdimi i trajnimit të gjyqtarëve dhe stafit administrativ për shfrytëzimin e teknologjisë - programeve elektronike.

VII. Konkludimi

Në bazë të dhënave statistikore dhe aktiviteteve, mund të shihet që performanca nuk është ashtu siç kemi pritur gjatë këtij tremujori, mirëpo gjendja e pandemisë ka bërë që të jetë kjo performancë, po ashtu dihet që këto tre muaj janë të dedikuar edhe për shfrytëzimin e pushimeve vjetore dhe për këtë arsye ka rënie të efikasitetit të zgjidhjeve gjyqësore.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Ramiz Azizi _____

Data: 11.10.2021

